

Franciscan archival legacy and its invaluable insights into the Albanian culture

Abstract: *Franciscan archival legacy covers a wide range of disciplines, with outstanding names who contributed to the exploration of different topics on anthropology, ethno-culture, folklore, oral tradition, archaeology, customary laws, translation of biblical books as well as textual philology. In fact there is a large number of transliterations and transcriptions of books, both for scholars and students. Translations of the gospels, critical editions of important early literary works in Albanian remain to this day a very important contribution to our culture, which helped to preserve and consolidate Albanian cultural heritage. However, Franciscan contribution goes beyond a certain number of books and essays and involves other archives too, especially when considering Albanology.*

Trashëgimia arkivore françeskane, është e përfaqësuar në fusha komplekse të dijes dhe me emra njerëzish të shquar, kontribues model në pikëpamje të hulumtimit të një sërë lamijesh që lidhen me antropologjinë, etnokulturën, folklorin e kulturën e lëvrimin të krijimtarisë gojore, arkeologjinë, të drejtën zakonore, traditën e shqipërimit biblik në gjuhën tonë, gjithashtu filologjinë e teksteve, prirje kjo që konkretizohet në disponimin e jo pak materialeve të transliteruara dhe të transkribuara, apo dhe në hartimin e teksteve qoftë dhe me destinacion shkollor, por që mbeten themelore në traditën e studimeve mbi historinë e shkrimit në gjuhën shqipe. Konkrete mbeten të tilla kontribute në formatin e shqipërimeve të ungjijve, në përgatitjen e botimeve kritike të rëndësishme për leximin e veprave të letërsisë së vjetër shqipe, në përkushtimin e vazhdueshëm për të ruajtur e konsoliduar trashëgiminë kulturore të botës shqiptare. Pjesë e këtyre kontributeve mbeten gramatikat e gjuhës shqipe, por dhe manuale gramatikore të rëndësishme të latinishtes që duke u shqipëruar bëjnë të pashmangshme qasjen me dukuritë e tiparet themelore të gjuhës sonë (një pjesë e mirë mbetur dhe sot e kësaj dite si sprova në dimensionin fizik të dorëshkrimit); sprova me vlerë që synojnë të përafrojnë studentin liceal me qytetërimin antik grek e romak; vjelje materiale nga folklori e bota legjendare; vëzhgime mbi kanunin dhe interpretime në pikëpamje të antropologut dhe etnologut të sytheve themelore të tij; shqipërime

doracakësh në thelb të destinuara për nivele gjimnazike e shkollore, por bartëse nocionesh e teorish të rëndësishme për formimin moral e personal në fushë të filozofisë e teologjisë. Figura e Skënderbeut gëzoi për një kohë të gjatë vëmendjen prej gjurmuesish të etërve të urdhrat të Shën Françeskut, vëmendje që pasqyrohet jo vetëm në botime specifike që ruajnë qartë linjën e trajtimit të një figure të rëndësishme për kombin e psiken kombëtare,¹ por dhe në dorëshkrime që përmbajnë të dhana po aq të veçanta për jetën dhe veprimtarinë e këtij të fundit. Historiku i nderimit të figurave themelore në liturgji dhe në jetën e krishterë në Veri të Shqipërisë (në veçanti ajo e Zojës së Shkodrës) pasqyrohet gjithashtu në të tilla shënime që në botime të afërta presin të shfaqen në përmasat e studimeve të mirëfillta.²

Nuk mungoi vëmendja as ndaj historikut të shkollave në gjuhën amtare, fakt ky që konkretizohet dhe në evidentime të inicimit të shkollave në vise ku kultivohej besimi i krishterë e ku prirja për të simbiotizuar studimin e gjuhës e leximit me brendësimin e kulturës kishtare e praktikën e respektimit të sakramendeve është mjaft e gjallë. Një argument i tillë gëzon një interes të gjallë dhe në ditët e sotme, ndërkohë që trajtohet e rimerret dhe në veprimtari shkencore të tribunave më të rëndësishme të albanologjisë.³

Trashëgimia kulturore françeskane përfaqësohet dhe nga opuskula modeste në pikëpamje vëllimi të realizuara në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, por që në të vërtetë përmbajnë thesare trajtesash në pikëpamje ezegjetike e përmbajtësore të pjesëve nga Ungjijtë, në përputhje me ecurinë e kalendarit liturgjik të kohës (rasti i Omelive dhe i letrave baritore të Atë Vinçens Prennushit O.F.M.);⁴ nga doracakë të botuar në kohën e vet nën destinacionin e fletoreve a qarkoreve që rievokonin historinë e urdhrave që lidhen me Shën Françeskun e Shën Kiarën e që kishin qëllimin e mirëfilltë të një shërbimi funksional në historinë e mbarëvajtjen e urdhrat përkatës

1 U referohemi shkrimeve që në vijimësi panë dritën e botimit dhe në të përkohshmet *Zâni i Shna Ndout* dhe *Hylli i Dritës*, veçanërisht shkrimeve të Atë Marin Sirdanit O.F.M. dhe të Atë Athanas Gegajt O.F.M.

2 U referohemi në veçanti shënimeve të daktilografuara që mbajnë autorësinë e Atë Marin Sirdanit O.F.M., që ruhen dhe aktualisht në Arkivin e Bibliotekës Françeskane në Shkodër e në të cilat trajtohet hollësisht historiku i kultit të Zojës së Këshillit të Mirë e nderimi i saj në viset veriore të Shqipërisë. Edhe në të tilla shënime ndërmendet figura e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit.

3 Kurti D. O.F.M., *Vepra kulturele e Elementit Katolik në Shqypni, Botim i Hyllit të Dritës*, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1935, f.6 v.

4 Prennushi V. O.F.M., *Lumnit e Kalvarit e dhunët e paganizmit*, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1925; Prennushi V. O.F.M., *Sakramendi i Elterit (letër baritore)*, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1937.

kishtar;⁵ nga artikuj specifike të shkruar e botuar në të përkohshme që ishin iniciuar e konsoliduar në frymën e përshtirjes së françeskane (*Zâni i Shna Ndout*); nga nënvizimi i vijueshëm i faktit që krishtërimi ndër shqiptarë mbetet një e vërtetë e qenësishme, që pasqyrohet gjerësisht dhe në një arsenal krijimesh me burim popullor që u mbledhën me një përkujdesje shembullore dhe nga etërit françeskanë. Të përkohshme të rëndësishme dhe që përfaqësojnë emra në zë të historisë së shtypshkrimit shqiptar bënë të mundur që të evidentohet një pjesë e mirë e asaj pasurie kombëtare kryesisht gjuhësore e letrare që me durim e këmbëngulje mblidhej e bëhej e ditur në numrat përkatës të tyre.⁶

Përpjekjet për të hedhur themelet e të nxënimit të elementeve themelore të besimit të krishterë, por dhe të gjuhës e të leximit në shkollat e Pëdhanës apo Blinishtit, nuk mbeten të veçuara në ngjarje spontane e që nuk kanë të bëjnë me realizimin e sprovave për të përpiluar gramatika, fjalorë dygjuhësh e vepra të tjera me vlerë. Është patjetër një periudhë që do të shënohet dhe nga arritje që i vlejnë para së gjithash historisë së shkrimit të shqipes dhe traditës së botimeve kryesisht didaktike mbi besimin.

Për ta shprehur me fjalët e Atë Donat Kurtit O.F.M. prirjen e fortë për gjithëpërfshirje në pikëpamje disiplinash e drejtimesh studimi, që nënvizon faktin *se s'ka kënd degë ditunijet qi s'â marrë para sysh, përfshihet në një katalog të madh besimi, morali, gramatologjia, letratyra, historia, sociologjia, didaktika, filozofija, shkenxat positive etj.*⁷

Kenësia e kësaj fryme pozitive e ngulmimi konsekuent në konsolidimin e disiplinave themelore në albanologji ndërpritet egërsisht nga fuqizimi i një regjimi totalitar që bëri të pamundurën për të minimizuar ndikimin e kulturës kishtarë dhe vetë praktikimin e riteve të besimit në vendin tonë, duke synuar gjithashtu dhe zhvlerësimin e një sërë kontributesh të papërsëritshme në fushë të gjurmimeve historike, arkeologjike, etnofolklorike, gjithashtu filologjike. Dëmtimi i trashëgimisë kulturore françeskane pasqyrohet dhimbshëm e bindshëm në shënimet e Atë Zef Pllumit O.F.M. (veçanërisht në libërthat me titull *Françeskanët e mëdhaj*⁸ dhe *Ut heri dicebamus*), në kujtimet e të cilit evidentohet me hollësi gjendja, por dhe fati i sa dorëshkrimeve e i veprave që në të vërtetë janë dëshmi

5 Prelaj M., *Jeta e Sh'Kjarës prej Asizit*, Shtypshkroja e së Paperlyemes, Shkodër, 1914; *po ai*, *Nji visár i panjoftun: I Treti Urdhen i Sh'Françeskut*, Shtypshkroja e së Paperlyemes, Shkodër, 1916.

6 Shih në veçanti Dema B., *Shtypi Françeskan në Shqypni*, në *Hylli i Dritës*, n.12, 1940, f.605-626. Në këtë trajtesë që rimerret më tej dhe në numra pasues të *Hyllit të Dritës* përmbahet dhe paragrafi me titull *Vepra të botueme e dorëshkrime* (po aty, f.607 v.).

7 Kurti D. O.F.M., *Vepra kulturele e Elementit Katolik në Shqypni*, Botim i Hyllit të Dritës, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1935, f.18.

8 Pllumi Z. O.F.M., *Françeskanët e mëdhaj*, Botime Françeskane, Tiranë, 2001; Pllumi Z.A., *Siç thonim dje (Ut heri dicebamus)*, Tiranë, 2002.

përpyekjesh e gjithashtu të një përkushtimi deri në vetëmohim të mjaft figurave të rëndësishme që lanë gjurmë të pashlyeme në historinë e kombit tonë, jo vetëm në atë të urdhrit të cilit i përkisnin.

Materialet arkivore që dëshmojnë gjerësisht përkushtimin e vazhdueshëm dhe kontributet në vijim të etërve të urdhrit të shën Françeskut në të mirë të përparimit të dijes së albanologjisë ruhen sot e kësaj dite në arkivin e bibliotekës “Atë Gjergj Fishta” në Shkodër, ndërkohë që vijojnë të gjinden dhe në përbërje të arkivave specifike të bibliotekës së qytetit të Shkodrës, arkivave të instituteve studimore pranë qendrash kombëtare të kërkimit shkencor në vendin tonë, gjithashtu në një masë më se të konsiderueshme në Arkivin Qendror të Shtetit. Gjinden të ruajtura pikërisht në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë shënime të plota të Atë Justin Rrotës O.F.M. në fushë të gramatikës së shqipes, një variant ky që shërbeu për përgatitjen e botimit të veprës me titull *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, realizuar në kuadrin e kolanës Botime Françeskane, në vitin 2006.

Materiale nga fusha e etnokulturës, e drejta zakonore gjithashtu gjurmohen në Arkivin e Antropologjisë së Institutit të Antropologjisë kulturore të ASA, Tiranë. Përveç kontributeve të meshtarëve dioqezanë si Dom Ernesto Cozzi apo Dom Frano Illija, do të citonim në këtë rasë punime të Atë Benardin Palajt O.F.M. si *Regjistrimi i kishës së Toplanës* (27 faqe); *Mbi kanunin e maleve* (42 faqe); *Vesha e zëjtaria ndër male* (18 faqe); gjithashtu dhe një kontribut që mban emrin e Emid Tedeschinit dhe që titullohet pikërisht *Dorëshkrime arkivore të pabotueme të Gjeçovit në lidhje me veprën e tij Kanuni i Lekë Dukagjinit* (27 faqe). Materiali arkivor i sipërcituar e i regjistruar në emër të Atë Benardin Palajt O.F.M. e që ka të bëjë me regjistrimin e kishës së Toplanës është sjellë për arkivin e këtij instituti prej studiuesit Rrok Zojzi, i cili kopjoi tekstualisht nga regjistri i kishës së Toplanës shënime autografe të Atë Palajt në nëntor të vitit 1950.⁹

Ky material ofron një panoramë të gjerë mbi një zonë që ka gëzuar vëmendjen e etërve françeskanë që në kohë të hershme e që figuron dhe në regjistra kishtarë e në vjetarë që lidhen drejtpërdrejt me historinë e kishës shqiptare e të vetë urdhrit françeskan në Shqipëri. Përshkrimet e Atë Benardin Palajt O.F.M. ngjallin interes dhe për studiuesit e arkeologjisë kristiane, duke qenë se citohen e ndërmenden monumente kishtarë që dhe pse të dëmtuara nga koha apo rrethana të tjera, mbeten dëshmi e përpjekjeve për të ngulitur që në kohë të hershme në ato vise krishtërimin

9 Shih dhe shënimin përkatës që gjindet në hyrje të këtij materiali: *Këto shënime janë kopjuar tekstualisht nga “regjistri i kishës së Toplanës”, të gjitha autografe të P.Bernardin Palaj O.F.M. Kopjimi u bë në nëntor të vitit 1950. Originali iu kthye përsëri famullitarit të Shoshit prej të cilit qe marrë.*

dhe elemente qenësore të besimit të krishterë. Shënime me interes mbi etnokulturën dhe jetën zakonore të kësaj treve dhe në kohën kur jetonte vetë autori i këtyre radhëve, bashkë me të dhëna po aq të vjera në fushë të onomastikës dhe antroponimisë pasojnë në vijim trajtesat e sipërcituara mbi kishat dhe vendndodhjet e tyre (ubikimet) sipas burimeve shkencore të konsultuara prej Atë Benardin Palajt O.F.M., duke plotësuar kështu një dimension diakronik të kësaj tërësie vërejtjesh dhe konsideratash të përpiluara prej tij. Në të njëjtën linjë jemi të mendimit se duhet vështiruar dhe shkrimi me titull *Rreth Kishës s'Abatit e Fisit të Shalës*, botuar në dy numra të së përkohshmes *Hylli i Dritës* në vitin 1941 e që ka për autorë Atë B. Palajn O.F.M. e Atë Rrok Gurashin O.F.M.¹⁰

Arsenali i konsiderueshëm arkivor i ruajtur dhe aktualisht në ambientet e bibliotekës françeskane në Shkodër ruan në përgjithësi linja përmbajtësore që orientohen në disa fusha, përfshirë shënime të gramatologjisë, shpjegime etimologjike e gjithashtu në fushë të toponomastikës, të dhëna mbi shkollat shqipe, kryesisht mbi ato të iniciuara apo drejtuar nga etërit françeskanë, variante ungjijsh, shënime të destinuara për të ndërtuar aparatin kritik të veprave madhore, siç është rasti i interpretimeve të cilat Atë Viktor Volaj O.F.M. i ka përpiluar në lidhje me *Lahutën e Malcis*. Botime më të fundit që kanë qëllim të evidentojnë pikërisht një pjesë të pasurisë arkivore, por dhe të librit antikuar të kësaj biblioteke risjellin në vëmendje domosdoshmërinë e kthimit në një shkollë studimi të një pasurie të çmuar që i përket kombit shqiptar.¹¹

Spikasin mes këtij dokumentacioni emra të njohur që lidhen me fusha të veçanta të dijes së albanologjisë; është rezultat i një përkushtimi të shtrirë në vite një masë e konsiderueshme shënimesh, veprash e vepërzash që duhet të shohin dritën e botimit për të pasuruar kështu studimet në fushë të etnologjisë e antropologjisë kulturore, historisë së mesjetës shqiptare, historisë së udhëtimeve baritore në dioqezate Shqipnisë, historisë së arsimit shqiptar, historisë së gjurmimeve arkeologjike, historisë së arkivistikës, studimeve mbi tekstin biblik në gjuhën shqipe dhe çështjet e përshtatjes e përkthimit të tij, historisë së kompozimeve muzikore etj. Emrat e Atë Gjergj Fishtës, Atë Pal Dodajt, Atë Marjan Prelajt, Atë Gjon Shllakut, Atë Benardin Palajt, Atë Shtjefën Gjeçovit, Atë Ambroz Marlaskajt, Atë Antonin Fishtës, Atë Vincens Prennushit, Atë Marin Sirdanit, Atë Atanas Gegajt, Atë Pashko Bardhit, Atë Donat Kurtit, Atë Benedikt Demës, Atë Anton Harapit, Atë Justin Rrotës, Atë Viktor Volajt, Atë Martin Gjokës etj. përmbushin një

10 Shih përkatësisht Palaj B. O.F.M., Gurashi Rr.O.F.M., *Rreth Kishës s'Abatit e Fisit të Shalës*, në *Hylli i Dritës*, n.9-10, 1941, gjithashtu, *po ai, po ata autorë*, në *Hylli i Dritës*, n.11-12, 1941, f.492-502.

11 Demaj V. O.F.M., Kodheli S., *Libri antikuar për Shqipninë në Bibliotekën Françeskane*, Botime Françeskane, Shkodër, 2015.

panoramë të tillë gjurmimesh e përpjekjesh për t'i shërbyer albanologjisë dhe atdhetarisë me një përkushtim shembullor, intelektual e njerëzor.

Një fushë po aq e rëndësishme e jo pak e rrahur dhe në dekadat e fundit mbetet ajo e glotologjisë, e gjurmimeve gjuhësore e dialektologjike, gërshetuar në disa raste me sprova që synojnë të paraqiten si tejshkrime të plota e kësisoj të përafrojnë me të interesuarit për një fushë të veçantë të dijes veprat e letërsisë së vjetër shqipe. Kontributi i Atë Jak (Luigj) Marlekaj O.F.M. konkretizohet në drejtime koncize që kanë të bëjnë me studime të thelluara mbi aspekte të fonologjisë së shqipes dhe receptimin e shenjave të caktuara grafike në tekste themelore për historinë e shkrimit të shqipes¹²; në shkrime kritike që lidhen drejtpërdrejt me tekstet e vjetra shqipe dhe me botimet më të para të natyrës kritike e filologjike të veprave të letërsisë së vjetër shqipe¹³; me variante të plota të cilat synojnë transkribimin dhe interpretimin filologjik e tekstologjik të veprave të sipërpërmendura. Zhvillimet e gjuhësisë shqiptare dhe të studimeve specifike albanologjike kanë qenë gjithashtu në vëmendjen dhe interesin e Atë Marlekaj, dëshmi e së cilës mbetet dhe artikulli me titull *Gjuhësia shqiptare në dhetë vitet e fundit*, botuar në revistën *Shëjzat*, n. 9-12, 1966, një shkrim i mirëfillt shkencor e për më tepër dëshmi e një intuete unike në pikëpamje të shtrimit të drejtë e të bazuar metodologjikisht të çështjeve të gjenezës së shqipes dhe vendit të saj në një kontekst më të gjerë që përfshin gjuhë e kultura të tjera të afërta në pikëpamje gjenetike dhe gjeografike. Konsiderimi objektiv i një tradite studimore që u shërben si gjurmimeve në fushë të indoevropianistikës, ashtu dhe kontekstualizimit të gjuhës shqipe në një areal specifik përkatësie gjenealogjike dhe tipologjike përshkon natyrshëm shkrimin e sipërcituar të Atë Marlekaj O.F.M., interesat studimore të të cilit do të konkretizohen dhe në drejtime të tjera të përafërta vëzhgimi e hulumtimi.

Mbeten këto në të vërtetë drejtime permanente në studimet e Atë Marlekaj, kontributi i të cilit merr një vlerë përherë më aktuale dhe në ditët e sotme, ndërkohë që ngulmohet sërish në nënvizimin e domosdoshmërisë së disponimit të botimeve kritike e filologjike dhe për shqipërimet e variantet përkatëse që la Pjetër Budi, njëri prej autorëve më të rëndësishëm të traditës shkrimore të shqipes në gjashtëqindën e që gëzoi pa dyshim dhe interesin shkencor të Marlekaj.

Disponimi i varianteve të transkribuara lehtëson së tepërmi konsultimin, përafrimin me brendinë e përmbajtjen e veprës në fjalë, duke qenë gjithë korpusi tekstor i Pjetër Budit një arsenal më vete në pikëpamje të trajtave të përzgjedhura, leksikut specialistik të lëvruar, të dhënave aq të vyera që i

12 Marlekaj L. O.F.M., *Per lo studio delle palatali albanesi*, në *Aevum*, Rassegna di scienze storiche linguistiche e filologiche, n.XXI, 1943, f.80- 87.

13 Marlekaj L. O.F.M., *Doli libri më i vjetri i gjuhës shqipe*, në *Shëjzat*, n.1-2, 1959.

shërbejnë drejtpërdrejt dialektologjisë historike, çështjeve të interpretimit fonik të grafemave të caktuara, por dhe tekstor të përdorimeve të veçanta, këto të fundit dhe të përdorura rishtas nga vetë Pjetër Budi. Me këtë kontribut kaq të veçantë dhe unik siç është rasti i transkribimit dhe interpretimit filologjik të teksteve të veprës së këtij prelati, Atë Marlekaj O.F.M. plotëson një panoramë gjurmimesh që kërkon patjetër dhe të pasurohet me interpretime të natyrës filologjike, e në veçanti me sjelljen më afër për lexuesin e jo vetëm specialistët të teksteve të letërsisë së vjetër shqipe. Një prirje e tillë shfaqet në vijimësi në gjithë spektrin e sprovave që ky studiues i vyer i letrave të shqipes ndërmori në vite, ndërkohë që ushtronte dhe detyrën e docentit universitar në katedra të rëndësishme evropiane të glotologjisë, duke i shërbyer konkretisht dhe me përkushtim vetë albanologjisë.¹⁴

Përkujdesja për veprën *Pasëqyra e t'rfyemit (1621)* të shqipëruar e përshtatur nga Pjetër Budi konkretizohet në një vëllim në variant dorëshkrimi prej pothuajse 400 faqesh që përmbajnë riprodhimin në variant të transkribuar të Pasëqyrës, të shkruar me një kaligrafi të kujdesshme e korrekte, pajisur me shënime jo të pakta që kanë të bëjnë me çështje të interpretimit të trajtave të caktuara nga tekstet e Budit, gjithsesi në një gjendje boce dhe kur e zotëronte vetë autori Marlekaj. Varianti në fjalë është më afër transkribimit se transliterimit: përmban shenja diakritike që shënojnë kuantitetin zanor të rrokjeve të caktuara apo pjesëza proklitike (nyja apo trajta të shkurtra të përemrit vetor), nënvizime të thjeshta që gjithsesi rinëvizojnë faktin që mbetemi në një fazë të përpunimit të tekstit që kërkon rishikime të mëtejme e që çojnë në konkludime nga ana e përgatitësit të këtij teksti. Teksti lexohet qartë dhe në përgjithësi në të nuk ndeshen raste të shkrimit bashkë të sintagmave siç dhe ndodh në origjinalin e Budit, fakt që dëshmon për ndërmarrjen e një zgjidhjeje teknike që do të duhej të pasqyrohej dhe në një botim të mundshëm nga ana e Marlekajt të këtij dorëshkrimi. Shënime të thjeshta në kufirin mes fjalëve bëjnë të kuptosh se në tekstin origjinal të tilla elemente gjindeshin të shkruara njësh, një dukuri kjo më se e vënë në dukje dhe nga gjurmues të ndryshëm të veprës së Pjetër Budit.

Me të drejtë *Speculum confessionis* mbetet një doracak që tërheq ndjeshëm vëmendjen e studiuesve të filologjisë së tekstit. Në trajtesat që janë përpiluar në lidhje me vetë realizimin e *Pasëqyrës* nga ana e Budit janë rishtruar disa herë çështje të përmbajtjes që e dallonin si nga vetë varianti i cili duhet të ketë shërbyer si model referencial (*Speculum confessionis* i Emerio de Bonis i vitit 1611 sipas Gunnar Svanes), ashtu dhe nga vetë shqipërimet e tjera siç është dhe rasti i Doktrinës së Kërshtenë (1618), një

14 Marlekaj L., *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo (con la riproduzione fotografica di centotrentadue documenti)*, Liantonio editore, Palo del Colle, Bari, 1989.

doracak po aq me interes në pikëpamje studimi dhe të linjave kryesisht diakronike që mundëson të ndiqen në lidhje me këtë vepër.¹⁵ I përshkon këto shqipërime të Budit i njëjti fill tematik dhe i karakterizon i njëjti paracaktim i natyrës didaktike dhe edukative ndaj liturgjisë, por i dallon njëkohësisht specifika e vetë doracakut në fjalë, dallim që konkretizohet më së miri nëse i referohemi si Doktrinës, ashtu dhe Pasëqyrës.

Një orientim i rëndësishëm që dhe u cek më se një herë në kontekstin e kësaj trajtese mbetet dhe ai i shqipërimeve në fushë të tekstit biblik e të shkrimit të shenjtë, që pikërisht në radhët e fretënve gëzoi përherë, qoftë dhe në kohë të vështira, interes të pandalun e kureshtje të mirëfilltë shkencore. Eksplorimi i përkthimit kryesisht nga Vulgata i këtyre teksteve përbën një prej përvojave më unike që Atë Donat Kurti O.F.M. duket se ka përjetuar ndërkohë që dihet që nuk pati fatin të punonte në kushte të një normaliteti minimal në vitet e fundit të jetës së tij. Shqipërimi i Testamentit të Ri¹⁶ që Atë Donat Kurti O.F.M. përpiloi me kujdes dhe gjithnjë me referim ndaj burimesh të duhuna në pikëpamje shkencore dhe teologjike, përbën një thesar të vyer e jo vetëm në pikëpamje gjuhësore në kuptimin më të ngushtë të fjalës. Bëhet i mundur kështu gjurmimi i një korpusi tekstori që përmban një arsenal të çmuar përftesash e ndërtimesh që jo rrallë evokojnë dhe gjuhën e shkrimtarinë e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe.

Në çdo konsultim të mundshëm të fashikujve që patëm rastin të lexojmë e të studiojmë kohët e fundit prej këtij korpusi materialesh që mban autorësinë e Atë Donat Kurtit O.F.M., është më se e kuptueshme të shtrohet pyetja nëse do të ishte e mundur të vihehin dhe në shërbim të funksioneve liturgjike të tilla tekste, ashtu siç mund të jenë dhe variante të tjera të përpilueme me po aq zell, përkushtim e akribi shkencore dhe prej fretënve të tjerë(i referohemi në veçanti kontributit të pamatë në këtë drejtim të Atë Daniel Gjeçajt O.F.M.).¹⁷

Roli i rëndësishëm në këtë drejtim i Atë Benedikt Demës O.F.M.¹⁸, i Atë

15 Svane G., *How to read Budi's Speculum Confessionis*, në *Studia Albanica*, n.1, 1980; Svane G., *Formimi i gjuhës letrare shqipe siç paraqitet në "Pasqyrën e të rrëfyerit" të Budit(1621)*, në *Studime filologjike*, n.3, 1982.

16 Në frontespicin e njërit prej varianteve të teksteve biblike shkruara me kaligrafi të përpiluara nga dora e Atë Donat Kurtit O.F.M. e që kemi arritur të konsultojmë pranë Arkivit të Bibliotekës Françeskane në Shkodër gjendet i shënuar viti 1975.

17 Shih gjithashtu Gjeçaj D.O.F.M., *Kanga e kangëve*, në *Hylli i Dritës*, n.1, 2016, f.149-161. Shih në veçanti dhe paragrafin me titull *Brilante biblike të A.Daniel Gjeçaj O.F.M.*, përpiluar nga Redaksia e Hyllit të Dritës në HD, n.1, 2016, f.148. Shih sërish pjesë prej Ekleziasit përkthyer prej Atë D.Gjeçajt e botuar në *Hylli i Dritës*, n.2, 2016, f.245-264. Ky material mbyllet me shënimin e vetë shqipëruesit: *Përfundova përkthimin e parë të prenden me 20.10.2000, ora 20.P.Danjeli*.

18 Shih në veçanti *Jeta e krishtenë (librec këshillësh e msimesh sidomos për civila e intelektualë)*, perpunue prej A.Benedikt Dema O.F.M., Shkodër, Shtypshkroja Françeskane, 1942; *Mësimi i Besimit Katolik në kursin e naltë të lyceut klasik e real prej Dr.A.König*,

Donat Kurtit O.F.M., i Atë Daniel Gjeçajt O.F.M. gjithashtu konkretizohet si në shënime të natyrës arkivore, ashtu dhe në botime me vlerë që i shërbyen dhe në kohë më të hershme edukimit katekistik, teologjik dhe fetar të moshave shkollore, por dhe besimtarëve në përgjithësi.

Në përmbyllje të kësaj paraqitjeje të thukët do të rivinim në dukje që në objektin të kësaj trajtese mbeten si linja themelore vënia në dukje e kontributit të etërve françeskanë të Provincës së Zojës Nunciatë në Shkodër si në drejtim të përgatitjes së varianteve të transkribuara të veprave të letërsisë së vjetër shqipe, ashtu dhe në atë të shqipërimit të tekstit biblik në optikën e domosdoshmërisë së disponimit dhe në ditët e sotme të mjaft varianteve të tilla të denja për të nënvizuar pasuritë e gjuhës shqipe dhe varietetet gjuhësore në të cilat shtjellohet diskursi biblik dhe fryma e shkrimit të shenjtë. Të shumta janë disiplinat në të cilat kontribuan ndjeshëm etërit françeskanë të kësaj province, ashtu si dhe vetë kontributet e lëna për brezat e që presin dhe sot e kësaj dite të shohin dritën e botimit dhe në variante të përgatitura me përkujdesje e vëmendjen e duhur shkencore.

Bibliografi

- BARDHI P., *Permii një dokument t'vjetës 1610*, në *Zâni i Shna Ndout*, n. III, 1917.
- BARDHI P., *Udhëtimi i T'Emzot Marin Bizzit, kryepeshkvit të Tivarit, nëpër Shqipëri në v.1610*, në *Zâni i Shna Ndout*, n. VI, 1918.
- BARDHI P., *Më i mëçmi alfabet i gjuhës shqipe*, në *Zâni i Shna Ndout*, n. I, 1920.
- BARDHI P., *Alfabeti i përdoruem prej shkrimtarësh të mëçm t'Gegnës*, në *Zâni i Shna Ndout*, n. II, 1920.
- BARDHI P., *Libri i D.Gjon Buzukut*, në *Zâni i Shna Ndout*, n. II, 1920.
- BARDHI P., *Alfabeti të përdoruem prej shkrimtarësh shqiptarë t'Italis*, në *Zâni i Shna Ndout*, n. IV, 1920.
- BARDHI P., *Naum Veqilharxhi e Anastas Kullurjoti*, në *Zâni i Shna Ndout*, n. V, 1920.
- DEMA B., *Shqipëria katolike në vjetë 1671*, në *Hylli i Dritës*, n. 7-8, 1932.

Bleni i parë: Mësimi i përgjithët i Besimit (Apologjëtika), punue shqyp simbas botimit të 19-të të origjinalit prej A.Benedikt Dema O.F.M., Shkodër, Shtypshkroja A.Gjergj Fishta, 1943. Shih gjithashtu Mësimi i veçantë i besimit (punue shqip simbas botimit të 17 t'origjinalit prej A.Benedikt Demës O.F.M., prof.në Lycen "Illyricum" të Shkodrës, Shkodër, 1944; Mësimi i Besimit katolik në kursin e naltë të lyceut klasik e real prej Dr.Arthur König(prof.n'Universitetin e Breslaut), Bleni i katërt, Mësimi i moralit, punue shqip simbas botimit të 16 e 17 t'origjinalit prej A.Benedikt Dema O.F.M., prof. në Lycén "Illyricum" të Shkodrës, Shkodër, Shpija Botuese A.Gj.Fishta, 1945.

- DEMA B., *Shtypi Françeskan në Shqypni*, në *Hylli i Dritës*, n. 12, 1940.
- DEMA B., *Shtypi Françeskan në Shqypni*, në *Hylli i Dritës*, n. 11-12, 1941.
- DEMAJ V., KODHELI S., *Libri antikuar për Shqipninë në Bibliotekën Françeskane*, Botime Françeskane, Shkodër, 2015.
- DEMIRAJ B., *Jetë rishtarësh shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Feros (1663-1746)*, në *Hylli i Dritës*, n. 1-2, 2015.
- DEMIRAJ B., *Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. I. Frang Mark Bardhi (1606-1643)*, në *Hylli i Dritës*, n. 1, 2016.
- DEMIRAJ B., *Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. II. Andrea Bogdani (1607-1683); III. Rinia dhe formimi teologjik-intelektual i Pjetër Bogdanit; IV. Gjergj Toliq si hartues i Letrës së Pleqve të Gashit (1689)*, në *Hylli i Dritës*, n. 2, 2016.
- DEMIRAJ B., *Enciklika "Inter Omnigenas" e Papë Benediktit XIV (2 shkurt 1744) dhe roli i Imzot Gjon P. Nikollë Kazazit në përfitim të saj*, në *Shëjzat-Pleiades*, n. 1-2, 2016.
- FISHTA F., *Dorëshkrime të Bibliotekës Nacionale të Parisit*, në *Hylli i Dritës*, n. 9, 1938.
- FISHTA F., *Gjurmimet e një mueji në Romë*, në *Hylli i Dritës*, n. 10-11, 1940.
- GEGAJ A.P., *Mësimi i gjuhës shqipe në Romë në shek. XVIII*, në *Hylli i Dritës*, n. 4, 1931.
- GEGAJ A.P., *Veprë arsimore e Françeskajvet në Shqypni në shekullin XVI*, në *Hylli i Dritës*, n. 3, 1932.
- GJINAJ M., *100 vjetë botime françeskane (bibliografi)*, Botime Françeskane, Shkodër, 2016.
- Harapi A., *Kisha e Zojës*, në *Zëni i Shna Ndout*, n. IV, 1917.
- GJEÇOV Sh. K., *Për histori të Kishës së Zojës*, në *Zëni i Shna Ndout*, n. XII, 1917.
- KURTI D., *Vepra kulturore e Elementit Katolik në Shqypni*, *Botim i Hyllit të Dritës*, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1935.
- LEGRAND É., *Bibliographie albanaise, ribotim anastatik me plotësime nga L. Skendo e H. Guys*, Botime Françeskane, Shkodër, 2011.
- MARLEKAJ J., *Karakterit i Letratyrës kombtare*, në *Hylli i Dritës*, n. 7-8, 1932.
- MARLEKAJ L., *Per lo studio delle palatali albanesi*, në *Aevum*, *Rassegna di scienze storiche linguistiche e filologiche*, n. XXI, 1943.
- MARLEKAJ L., *Doli libri më i vjetrit i gjuhës shqipe*, në *Shëjzat*, nr. 1-2, 1959.
- MARLEKAJ L., *Gjuhësia shqiptare në dhetë vitet e fundit*, në *Shëjzat*, n. 9-12, 1966.
- MARLEKAJ L., *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo*, Liantonio editore, Palo del Colle, Bari, 1989.
- PACI E., *"Hylli i Dritës", tribunë e përrurimit të studimeve albanologjike*, në *Hylli i Dritës*, numër jubilar me rastin e 100-vjetorit, Shkodër, 2013.
- PALAJ B., GURASHI Rr., *Rreth Kishës s'Abatit e Fisit të Shalës*, në *Hylli i Dritës*, n. 9-10, 1941; n. 11-12, 1941.

- PRELAJ M., *Jeta e Sh'Kjarës prej Asizit*, Shtyshkroja e së Paperlyemes, Shkodër, 1914.
- PRELAJ M., *Nji visár i panjoftun: I Treti Urdhen i Sh'Franceskut*, Shtyshkroja e së Paperlyemes, Shkodër, 1916.
- PRENNUSHI V., *Lumnít e kalvarit e dhunít e paganizmit*, Shtypshkroja Franciskane, Shkodër, 1925.
- PRENNUSHI V., *Sakramendi i Elterit(letër baritore)*, Shtypshkroja Franceskane, Shkodër, 1937.
- RROTA J., *Letratyra shqype për shkolla të mjesme*, Shkodër, 1925.
- RROTA J., *Per historín e Alfabetit Shqyp*, në *Hylli i Dritës*, n. 2-3, 1936.
- RROTA J., *Hulumtime dhe shenjime mbi Gjon Buzukun*, në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, n. 3, Tiranë, 1956.
- RROTA J., *Per historín e alfabetit shqyp dhe studime tjera gjuhesore*, Botime Franceskane, Shkodër, 2005.
- RROTA J., *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime Franceskane, Shkodër, 2006.
- SARRO I., *Francescani nelle diocesi di Scutari e di Pulati nella seconda metà del XVIII secolo*, në *Hylli i Dritës*, n. 4, 2007.
- SARRO I., *Kontribut për historinë kishtare të Shqipnisë së epërme(shek.XVII-XIX)*, Botime Franceskane, Shkodër, 2015.
- SEDAJ E., *Bibla e përkthimet e saj në gjuhën shqipe*, Botime Shtufi, Prishtinë, 1999.
- SIRDANI M., *Vepra atdhetare françeskane*, në *Hylli i Dritës*, n. 12, 1940.
- SVANE G., *How to read Budi's Speculum Confessionis*, në *Studia Albanica*, n. 1, 1980.
- SVANE G., *Formimi i gjuhës letrare shqipe siç paraqitet në "Pasqyrën e të rrëfyemit" të Budit (1621)*, në *Studime filologjike*, n. 3, 1982.